



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA  
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**C.nr.167/12**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, departamenti i përgjithshëm** (e vendosur ne objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual **Faton Ademi**, me procesmbajtësen Elheme Peci në çështjen juridike të paditëses: \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_, I \_\_\_\_\_ të cilën e përfaqëson \_\_\_\_\_, avokat sipas autorizimit me sukrim nga Ndihma Juridike në Mitrovicë, kundër të paditurve: \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ Komuna e \_\_\_\_\_, baza e kontestit: Alimentacion, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 08.01.2013 me datën 14.01.2013 bie këtë:

### **A K T G J Y K I M**

- **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditëses \_\_\_\_\_ nga fshati \_\_\_\_\_ Komuna e Mitrovicës me të cilin ka kërkuar nga gjykata që në fillim ta detyrojë të paditurin e parë - (babën e fëmiut) e më vonë pas zgjerimit të padisë edhe të paditurin e dytë \_\_\_\_\_ (gjyshin e fëmiut) që në emër të mbajtjes, ushqimit dhe kujdesit për fëmiun të paguajë shumë prej 100 euro çdo muaj, e më së largu deri me 5 -të muajit vijues për muajin paraprak
- Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

### **A r s y e t i m**

Paditësja me anë të padisë por edhe në seancë kryesore kërkoi nga gjykata që ta detyron të paditurin e parë Kujtim Kabashi babain e fëmiut të përbashkët që në emër të mbajtjes financiare për fëmiun e tyre të përbashkët t'ia paguajë paditëses shumë prej 100 euro çdo muaj. Në seancë i padituri \_\_\_\_\_ si provë se nuk është në gjendje financiare të kujdeset për fëmiun dorëzoi në gjykatë dëshminë se është i

papunë. Në këtë seancë i autorizuari i paditëses kërkoi nga gjykata që t'i drejtohet organit të kujdestarisë për zgjerimin eventual të padisë edhe ndaj anëtarëve tjerë të familjes. Organi i kujdestarisë zgjeroi padinë edhe ndaj gjyshit të fëmiut pasi që i njëjti është i punësuar dhe realizon të ardhura financiare.

I padituri i dytë deklaroi në seancë se është e vërtet se është i punësuar mirëpo është gjithashtu i obliguar t'i paguajë dy kredi, njëren në emër të babait të paditëses, ndërsa tjetren që e ka marrë për vete dhe se nga paga i mbeten afërsisht 64 euro, përndryshe do të ishte në gjendje që të përkujdesej për fëmiun e palëve ndërgjyqëse.

Gjykata në procedurën provuese administroi këto prova: kontrata e punës në emër të të paditurit të dytë, fletëtërheqjen e të hollave nga Banka për Biznes në emër të të paditurit të dytë, kontrata për kredi konsumuese në emër të të paditurit të dytë, fletpagesa në emër të por që si pages figuron i padituri i dytë certifikata mbi papunësinë e lëshuar nga Qendra Regjionale për Punësim në Prizren në emër të paditurit të parë.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi në pajtim me nenin 7 të LPK-së.

Në fjalën përfundimtare pala paditëse përmes të autorizuarit të saj deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe deklaramëve nga seancat e kaluara, pasi që konsideroi se padia është e themeltë dhe e bazuar në Ligjin për Familjen i Kosovës, shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi, pasi është angazhuar nga Ndihma Juridike.

I padituri i parë deklaroi se qëndron në tërësi pranë thënieve nga seancat e kaluara. I padituri i dytë se gjithashtu edhe ai qëndron prapa thënieve nga seancat e kaluara dhe se nuk se çka të shtoi ndërsa nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Gjykata në bazë të provave të administruara në seancë erdhi në përfundim se kërkespadia e paditëses duhet të refuzohet si e pabazë për këto arsye:

Në bazë të Ligjit për Familjen i Kosovës neni 330 që flet për parimet e përcaktimit të mbajtjes dhe alimentacionit, ku në paragrafin 2 thuhet: citoi: " Gjykata duhet të ketë parasysh gjendjen financiare të të paditurit, aftësinë për të punuar, mundësinë faktike për punësim, kushtet shëndetësore, nevojat personale, detyrimet ligjore dhe të gjitha kushtet tjera relevante".

I padituri i parë është i papunë dhe nuk mund të ngarkohet me këtë detyrim, në aspektin shëndetësor qëndron mirë, në aspektin e aftësive për punë gjithashtu mirë, por nëse i referohemi kushteve dhe rrethanëve apo mundësive reale për tu punësuar në Kosovë është shumë e vështirë, sepse numri i të papunëve është i madh, andaj edhe i njëjti nuk mund të obligohet me këtë barrë sepse nuk mund ta bartë pasi gjendja e tij veq se do të rrezikohet më shumë në aspektin financiar, sepse për të marrë ai këtë obligim duhet të realizojë të hyra financiare, dhe kjo më së miri vërtetohet në bazë të certifikatës për punësim që është konstatuar se i njëjti është i papunë, ndërsa paditësja nuk kishte prova tjera që dëshmojnë se i njëjti realizon të hyra nga burime tjera financiare.

Ndërsa sa i përket të paditurit të dytë i njëjti është në marrëdhënie pune ku paga mujore e tij është 215 euro, mirëpo i njëjti ka një kredi konsumuese për 5 vite të cilën e ka lidhë me datë: 04.03.2011, ndërsa gjithashtu në emër të ( babai të paditëses) ky i paditur paguan në emër të kredisë, dhe nga paga që merr i padituri i dytë, atij i mbetën 64 euro, dhe se nga kjo shumë ky i paditur nuk mund të ngarkohet me alimenatcion sepse është në pamundësi financiare.

Andaj gjykata duke u bazuar në provat e administruara më lartë vërtetoi se pikërisht për shkak ta pamundësisë financiare të të paditurve padia e paditëses duhet të refuzohet si e pabazuar.

Andaj, gjykata konform nenit 143 të LPK-së, nenit 330 të LFK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,  
C.nr.167/2012 me dt.14.01.2013**

**GJYQTARI,  
Faton Ademi**



**UDHËZIM PËR MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.

*exp:*

1.